

**FEDERATA SKITARE E KOSOVËS**  
Nr. 50/018 Dt. 06.11.2018  
Prishtinë



**FEDERATA SKITARE E KOSOVËS**  
**SKI FEDERATION OF KOSOVO**  
**SMUČARSKA FEDERACIA KOSOVA**  
**www.fs-kos.com, email: info@fs-kos.com**  
**House of Sport – Prishtina**

**Tel: +383 38 248 101, +383 49 501 091, +383 49 587 589, +383 44 476 182**

**P R O P O Z I C I O N E T**  
**E GARAVE TË FEDERATËS SKITARE TË KOSOVËS**  
**PËR VITIN KALENDARIK 2018/2019**

**KAMPIONATI I KOSOVËS**

**Brod, Korrik 2018**

## **PROPOZICIONET E KAMPIONATIT TË KOSOVËS 2018/19**

### **I DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

#### **Neni 1**

Organizator i Kampionatit të Kosovës për vitin 2018/19 në skitari është Federata Skitare e Kosovës.

#### **Neni 2**

Kampionati i Kosovës është garë individuale dhe ekipore për të gjitha kategoritë në konkurrencën e femrave dhe meshkujve duke filluar prej shpresave gjerë tek seniorët.

#### **Neni 3**

Të gjithë garuesit në Kampionatin e Kosovës marrin pjesë si anëtarë të regjistruar në klubet skitare pranë FSK-së.

#### **Neni 4**

Garat zhvillohen sipas rregullave të FSK-së dhe në harmoni me ato të FIS-it.

### **II TË DREJTË PJESËMARRËJE**

#### **Neni 5**

Të drejtë pjesëmarrje në Kampionatin e Kosovës kanë të gjithë garuesit e regjistruar në FSK dhe të verifikuar në bazë të librezës mbi anëtarësimin.

#### **Neni 6**

Në Kampionatin e Kosovës për vitin 2018/19 kanë të drejtë pjesëmarrje garuesit sipas këtyre viteve të lindjes.

-Shpresat e skitarisë së Kosovës (Vajzat- Djemtë) të lindur prej 2011 e më vonë.

Nr. Rend.	MOSHA	EMRI KATEGORIA	EMRI KATEGORIA	FILLIM VITIT	FUNDI I VITIT
1.	U-8	SHPRESHAT F.	SHPRESAT M.	2011	E MË VONË
2.	U-10	YLLKAT 1	FATOSAT 1	2010	2009
3.	U-12	YLLKAT 2	FATOSAT 2	2008	2007
4.	U-14	PIONERET E REJA	PIONERËT E RINJ	2006	2005
5.	U-16	PIONERET E VJETRA	PIONERËT E VJETËR	2004	2003
6.	U-18	JUNIORET E REJA	JUNIORËT E RINJ	2002	2001
7.	U-21	JUNIORET E VJETRA	JUNIORËT E VJETËR	2000	1998
8.	O-21	SENIORET	SENIORËT	1997	E MË HERËT

#### Neni 7

Garuesit mund të startojnë në kategorinë moshore (më të vjetër) vetëm me lejen e mjekut dhe të trenerit apo klubit, mirëpo nëse starton në atë kategori atëherë nuk ka të drejtë që në vitin e njëjtë të startojë në kategorinë më të ultë. Startimi nga një kategori në garën e parë nënukpton përfundimin e sezonës në atë kategori.

#### Neni 8

Kampionati i Kosovës, konsiderohet si i rregulltë nëse në gara marrin pjesë më së paku 3 (tre) e më shumë garues nga 3 (tre) klube të ndryshme skitare të regjistruara në Federatën Skitare të Kosovës.

#### Neni 9

Me qëllim të organizimit më të mirë dhe të stimulimit të kualitetit, ekipi duhë të ketë më së paku tre (3) e më shumë garues të kategorive të ndryshme.

#### Neni 10

Konform Nenit 8 të propozicioneve mundësohet dhe pranohet si garë e

rregulltë në një disiplinë nëse startojnë garues të rregulltë të 3 (tri) e më shumë klubeve skitare të Kosovës me nga 1 (një) garues të kategorive të ndryshme.

Nëse në cak do të arrinë vetëm një garues ai do të poentohet në mënyrë të rregulltë.

### III POENTIMI DHE CAKTIMI I PLASMANIT

#### Neni 11

Kampion individual i Kosovës është garuesi nga territori i Kosovës i cili arrinë rezultat më të mirë gjatë vitit kalendarik në garat vendore dhe ato ndërkombëtare sipas kritereve të caktuara nga Këshilli Profesional dhe të aprovuara nga Bordi i FSK-së .

Kampion individual i Kosovës ne disciplina të veçanta është garuesi më i mirë i plasuar në bazë të rezultateve të aritura po në atë disiplinë.

Garuesit tjerë plasohen sipas rezultateve të arritura në disciplina të veçanta gjegjësisht të rezultateve të përgjithëshme pas përfundimit të të gjitha disiplinave.

#### Neni 12

Në Kampionatin e Kosovës është i detyruar poentimi i garuësve, sipas propozicioneve të FIS-it.

Place	Points	Place	Points	Place	Points
1	100	11	24	21	10
2	80	12	22	22	9
3	60	13	20	23	8
4	50	14	18	24	7
5	45	15	16	25	6
6	40	16	15	26	5
7	36	17	14	27	4
8	32	18	13	28	3

9	29	19	12	29	2
10	26	20	11	30	1

- Për garuesit Kosovarë që fitojnë pikë në garat ndërkombëtare, ata/ato nuk i sjellin pikë klubit të vet për plasman ekipor por ato pikë i llogariten për plasman individual.

Garuesit Kosovarë që marrin pjesë në garat ndërkombëtare nuk do të poentohen për Reprerentacion e Kosovës nëse koha e tij/saj e kalon 10 sekonda e më shumë se koha më e mirë e asaj gare. Garuesit do të vlerësohen sipas kësaj tabelle:

10 sec e më vonë	30 poena
9 sec e më vonë	35 poena
8 sec e më vonë	40 poena
7 sec e më vonë	45 poena
6 sec e më vonë	50 poena
5 sec e më vonë	55 poena
4 sec e më vonë	60 poena
3 sec e më vonë	65 poena
2 sec e më vonë	70 poena
1 sec e më vonë	75 poena

- Kampionati i Kosovës nuk është obligativ për të gjithë garuesit që jetojnë jashtë vendit dhe janë pjesë e reprezentacionit të Kosovës. Pikët e fituara nga këta garues në Kampionatin e Kosovës vlejnjë për plasman ekipor në Kosovë.

- Garuesit e shteteve të huaja nuk hyjnë në konkurrencë të barabartë me ata vendor, por rangohen sipas rezultateve vetëm në mes vehte.

- Në kategoritë ku nuk ka rivalitet/konkurrencë dhe koha e arritur e kalon penalltinë prej 4 sekonda për meshkuj dhe 5 sekonda për femra, për të dyja grahjet/lëshimet, garuesi në fjalë do të shpërblehet me medalje, mirëpo ky rezultat nuk do të përfshihet në përzgjedhje për Reprerentacionin e Kosovës. Penaltia prej 4/5 sekonda do të kalkulohet nga koha më e mirë e asaj gare pamvarësisht gjinisë dhe varësisht nga gjatësia e shtegut/kategoria.

#### IV DISPOZITAT PËR PAISJET OBLIGATIVE TË GARUESËVE

##### Neni 13

- Për U-12 e më poshtë: Vetëm helmata është obligative kurse kombilizoni është i preferuar por asnjëra sipas normave të FIS-it. Rekomandim për këtë kategori: Përdorni vetëm një palë ski për të gjitha disiplinat në qoftë se gjatësia e skive është me e vogël se 130 cm.

##### Neni 14

-Për U-12 e më poshtë: garat në Sllalom të Madh do të organizohen sipas mundësive në shtigje të veçanta, ndërsa në mungesë të kushteve do të garojnë në shteg të njëjtë për Yllka (U-10) dhe Shpresa (U-8) me shteg të shkurtuar mirëpo vendosja e portave do të jetë sipas kriterëve të pionerëve (U-12), për Sllalom të Madh maksimumi i distancës është 20m ndërsa distanca normale në mes portave është 17m – 20m.

##### Neni 15

-Për U-14 e lartë: Helmata, syzet dhe kombilizoni duhet të jenë obligative por jo sipas normave të FIS-it.

##### Neni 16.

**Për Disiplinën e Sllallomit të Madh, vlejné:**

-Për kategoritë U-14 dhe U-16 skitë duhet të jenë obligative sipas gjatësisë deri në 188 cm ndërsa radiusi i preferuar është 17 m e më lartë.

-Për kategoritë U-18 dhe lartë, për Femra – gjatësia është 188 cm e më lartë dhe radiusi duhet të jetë 25 m ndërsa për Meshkuj gjatësia është 193 cm e më lartë dhe radiusi 30 m. Për kategoritë U-18 dhe lartë gjatësia e skive ka tolerancë +/- 5 cm ndërsa radiusi ka flex/tolerancë prej +/- 5 m (pesë metra) sipas standardeve të FSK-së (Kësaj rregulloreje) dhe FIS-it.

- Shtegu duhet të trasohet në bazë të kategorive dhe paisjeve/rekuizitave të garuesëve/eve (që nënkupton, për kategorinë e Pionereve/ëve të Reja/Rinj(U-14) dhe të Vjetra/Vjetër (U-16) = 1 shteg – ku portat nuk duhet të e kalojnë minimumin (21m – 25m) dhe

maximumin (27m), ndërsa Junior (U-18) dhe Senior (O-18) = 1 shteg – ku portat nuk duhet të e kalojnë minimumin (24m – 27m) dhe maximumin (30m)).

#### Neni 17

**Për Disiplinën e Sllallomit vlejné:**

-Për kategoritë U-18 e më lartë, për Meshkuj gjatësia e skive është 165 cm dhe për Femra 155 cm, ku toleranca është +/- 5cm varësisht prej gjatësisë së garuesit.

-Për kategoritë U-14 dhe U-16, gjatësia e skisë duhet të jetë më e madhe se 130 cm për të dy gjinitë.

#### Neni 18

**- Kategoria e shpresave poentohet për plasman ekipor dhe për plasman individual.**

#### Neni 19

Prej këtij viti shpallja e sportistëve të vitit do të organizohet sipas këtij propozimi:

- 5 skitaret (F) dhe 5 skitarët (M) më të mirë të kategorisë O-18 (Junior dhe Senior)
- 5 skitaret (F) dhe 5 skitarët (M) më të mirë të kategorisë U-14 dhe U-16 (Pionerët/et e Rinjë/eja dhe të Vjetër/ra)
- 5 skitaret (F) dhe 5 skitarët (M) më të mirë të kategorisë U-08, U-10 dhe U-12 (Shpresa, Yllka/Fatosa 1 dhe 2)

#### Neni 20

Bordi i FSK-së, sipas nevojës, me propozimin e Këshillit Profesional për avansimin e garave mund të nxjerr udhëzim plotësues për poentim për një vit garues për disciplina dhe kategori të veçanta sipas rregullave për poentim në FIS.

#### Neni 21

Plasmani i ekipeve caktohet ne baze te poenave të pergjithshëm te garuesve te nje ekipi te seciles kategori moshore sipas disiplinave dhe ne baze te

poenave te pergjithshëm te të gjitha kategorive moshore.

#### Neni 22

Poentim individual dhe ekipor sjellin garuesit e regjistruar pranë Federatës Skitare të Kosovës të cilët vërtetohen me librezat të lëshuara dhe vërtetuara nga FSK për çdo vit kalendarik.

#### Neni 23

Një ekip ka të drejtë të paraqesë 7 (shtatë) e më tepër garues për një kategori mirëpo vetëm 7 (shtatë) garuesit me kohën më të mirë poentohen.

#### Neni 24

Paraqitja e klubit dhe individëve bëhet së paku 24 orë para fillimit të garave përmes email-it zyrtar të FSK-së: [info@fs-kos.com](mailto:info@fs-kos.com) ose me prezencë në takim të Këshillit Organizativ.

Ndërrimi i garuesëve/eve të paraqitur më herët mund të bëhet së paku 2 orë para tërheqjes së shortit për garë.

### V PRANIMI DHE KONTROLLIMI I DOKUMENTACIONIT

#### Neni 25

Pranimin dhe verifikimin e dokumentacionit (librezave garuese) e bënë komisioni i garave të FSK-së. Pas verifikimit, komisioni është i obliguar t'i njoftojë përfaqësuesit e klubeve për lëshimet eventuale.

Klubet janë të obliguara që menjëherë t'i eliminojnë lëshimet në mënyrë që mos të ketë shkelje ose ç'rregullime në gara.

#### Neni 26

Tërheqja e numrave bëhet sipas rregullave të FSK-së dhe të FIS-it një ditë para fillimit të garave.

Tërheqja e numrave bëhet sipas marrëveshjes me udhëheqësit e klubeve me fletëparaqitje. Tërheqja e numrave bëhet sipas kategorive dhe disiplinave.



## Neni 27

Të gjithë garuesit duhet të e bëjnë kontrollimin mjekësorë që vërtetohet në librezat e garuesëve të lëshuara nga FSK-ja, mirëpo përgjegjësia për këtë është vetëm e klubit përkatës.

## VI VËREJTJET NË PARREGULLËSI TË GARAVE

### Neni 28

Klubet kanë të drejtë t'i paraqesin vërejtjet (ankesat) me shkrim përmes formularit të ofruar nga FSK, Komisionit të garave të FSK-së menjëherë pas përfundimit të njërit lëshim në afat prej 15 min gjatë garës gjegjëse me kaucion prej 30 euro. Nëse ankesa vërtetohet se klubi i cili është ankuar ka të drejtë atëherë kaucioni i deponuar i kthehet.

Komisioni i garave është i obliguar të vendosë për vërejtjen e paraqitur nga klubi në bazë të Rregullave të FSK-së dhe atyre të FIS-it.

Delegati teknik i FSK-së është i autorizuar për anulimin ose shtyerjen e garës një ditë para fillimit të garës.

## VII VERIFIKIMI DHE NDRYSHIMI I TERMINEVE

### Neni 29

Bordi i Federatës Skitare të Kosovës cakton terminet për mbajtjen e garave sipas kalendarit, dhe kushteve materialo-financiare.

Në rast të pengesave eventuale, për ndryshimin e terminit të mbajtjes së garës është i autorizuar Bordi i FSK-së.

## VIII SHPENZIMET PËR PJESEMARRJE

### Neni 30

Të gjitha shpenzimet për pjesëmarrje të garuesëve/eve dhe përfaqësuesëve të klubeve i bartin klubet.

## Neni 31

Federata Skitare e Kosovës për plasman në vendet 1,2 dhe 3 në çdo kategori dhe disiplinë ndanë medalje, diploma dhe sipas mundësisë financiare edhe dhurata modeste.

## VIII BULETINI DHE RAPORTI

### Neni 32

Shërbimi teknik është i obliguar të e përgaditë me kohë Buletinin dhe të i dorëzojë të gjitha klubeve dhe personave zyrtar.

### Neni 33

Sekretari i Përgjithshëm është i obliguar që më së voni 3 (tre) ditë pas përfundimit të Kampionatit të një discipline të i publikojë rezultatet në Web-Faqen zyrtare të Federatës Skitare të Kosovës.

## IX DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 34

Për spjegime, plotësime ose ndryshime të këtyre Propozicioneve, është kompetent dhe vendosë vetëm Bordi i Federatës Skitare të Kosovës.

### Neni 35

Me aprovimin e këtyre Propozicioneve sh'fuqizohen Propozicionet e garave të vitit paraprak.

## FEDERATA SKITARE E KOSOVËS

Prishtinë  
09.10.2018



z.Milaim Kelmendi  
President  
Federata Skitare e Kosovës